REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT - TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 576/23
Datë/Datum. 28.08.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSh. nr. 576/2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së OE "Grandelite" L.L.C., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Përmirësimi i infrastrukturës fizike shkollore me Nr. të prokurimit 615-23-1249-5-1-1, iniciuar nga KOMUNA E PODUJEVËS, në cilësinë e autoritetit kontraktues, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me datën: 28/08/2023, mori këtë:

VENDIM

1.Hedhet si e palejuar ankesa e operatorit ekonomik OE "Grandelite L.L.C.", e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datën 14/08/2023, numër protokolli 2023/0576, për aktivitetin e prokurimit "Përmirësimi i infrastrukturës fizike shkollore" me nr. të prokurimit: 615-23-1249-5-1-1, iniciuar nga KOMUNA E PODUJEVËS.

2.I lejohet, autoritetit kontraktues "KOMUNA E PODUJEVËS"që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Përmirësimi i infrastrukturës fizike shkollore", me numër të prokurimit 615-23-1249-5-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik të e-prokurimi me datë 14.08.2023, tek rubrika e ankesave ka pranuar një ankesë nga OE "Grandelite L.L.C.", për aktivitetin e prokurimit me "Përmirësimi i infrastrukturës fizike shkollore" me nr. të prokurimit: 615-23-1249-5-1-1, iniciuar nga KOMUNA E PODUJEVËS.

Zyra e pranimit të ankesave pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa edhe e dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka ofruar dëshminë siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së.

Nisur nga fakti se ankuesi ankesës së lartcekur, nuk i ka bashkangjitur konfirmimin e bankës për tarifën, zyra për pranimin e ankesave përmes sistemit e-prokurimi ka kthyer ankesën për plotësim tek OE si dhe me datën 18.08.2023 përmes email-it e ka njoftuar OE ankues se ankesës së cekur si më lart nuk i ka bashkangjitur formularin për sigurim të depozitës të Ankesës, ta plotësoj ankesën sipas nenit 111 të LPP në të kundërtën do të hedhet si e palejuar. Por edhe përkundër këtij njoftimi dhe sqarimi të OSHP-së deri me 28.08.2023, nuk ka pranuar ankesën e plotësuar sipas kërkesës së institucionit, duke mos ofruar dëshmi-konfimimin nga banka për tarifën e ankesës në fjalë.

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE "Grandelite L.L.C.".., e datës 14/08/2023 (protokoll 576/2023), për aktivitetin e prokurimit me titull me Përmirësimi i infrastrukturës fizike shkollore me nr. të prokurimit: 615-23-1249-5-1-1, iniciuar nga KOMUNA E PODUJEVËS konsiderohet si e pa kompletuar sepse ankuesi nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në piken 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së.

Andaj procedura e shqyrtimit të kësaj ankese përfundon në ketë fazë duke e hedhur të njëjtën si jo e plotë ngase kjo ankesë nuk plotëson kushtet për tu proceduar më tutje siç kërkohet dispozitat ligjore të lartcekura.

Autoritetit kontraktues – KOMUNA E PODUJEVËS, mund të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit (e përshkruar me sipër) nëse nuk ka ankesë tjetër për këtë aktivitet. Organi Shqyrtues i Prokurimit i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60, 65 të LPP-së.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarja e OSHP-së

Vjosa Gradinaj Mexhuani

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK KOMUNA E PODUJEVËS
1x1 "Grandelite L.L.C."
.1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së